



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 74, Datë 12.03.2021

MBI

“MIRATIMIN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË ERE PËR PERIUDHËN 2021 – 2023”

Në mbështetje të nenit 10, nenit 16 dhe nenit 18, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 25, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 12.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 35/7 prot., e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, për miratimin e objektivave strategjike të ERE për periudhën 2021-2023,

**Konstatoi se:**

- Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, në nenin 4, parashikon se Ministria përgjegjëse për energjinë: “(pika 2, germa “a”) Harton Strategjinë Kombëtare të Energjisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe përditësohet të paktën çdo pesë vjet. Strategjia Kombëtare e Energjisë përcakton objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë, si dhe rrugët e arritjes së tyre, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë kombëtare për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, (pika 2, germa “b”) harton programet afatmesme për zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë”.
- Strategjia e hartuar e që paraqitet për miratim vjen në përshtatje të plotë me frymën e paketës së katërt rregullatore “Clean Energy package” e cila ka në fokus të saj, vendosjen e rregullave që e bëjnë më të lehtë për konsumatorin që të prodhojë dhe të shesë energji si vetëprodhues, të garantojë transparencë për të drejtat e konsumatorit dhe mundësi më të mira zgjedhjeje sa i përket shërbimit dhe çmimeve.
- Plani strategjik dy vjeçar i propozuar për miratim, përbëhet nga: Misioni dhe objektivat e përgjithshme, Mbrojtja e Konsumatorëve përmes ndërjegjësimit dhe Dhënia zë konsumatorit.
- **Transparenca dhe integriteti në veprimtarinë administrative.**  
ERE është një organ administrativ i pavarur, i cili në përputhje me ligjin për Energjinë dhe Gazin Natyror, ushtron kompetencat me paanësi dhe transparencë;  
Është parim i konsoliduar në veprimtarinë e ERE-s që ushtrimi i kompetencave rregullatore të përfshijë procedura të bazuara në pjesëmarrje, si përmes konsultimit të personave, ekspertëve të fushës ashtu edhe në drejtim të grupeve të gjëra të interesit. Sa më sipër, është vlerësuar si një aspekt i rëndësishëm i llogaridhënies duke informuar mbajtësit e interesave

në treg në mënyrë adekuate dhe mbledhjen e mendimeve, opinioneve dhe propozimeve dhe duke i përfshirë ato sa më shumë që të jetë e mundur në procesin e vendimmarrjes brenda një kuadri rregullator të përcaktuar dhe duke iu referuar parimit të transparencës dhe paanshmërisë së veprimtarisë rregulluese.

- ERE konsideron të vijojë bashkëpunimin me ministrinë përgjegjëse për energjinë përmes ekipeve të përbashkëta për një sërë objektivash, duke filluar nga reforma në tregun e shitjes me pakicë, roli i funksionimit të sistemeve/operatorëve.
- ERE gjithashtu do të bashkëveprojë rregullisht me institucione të tjera, të tillë si: Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike në kuadër të bashkëpunimit për çështjet që lidhen me Zbatimin e masave të plota organizative dhe teknike të sigurisë kibernetike në sistemet e komunikimit dhe të informacionit si dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për çështjet që lidhen me klientët në nevojë.
- Sa i përket zhvillimit të tregjeve gjithnjë e më efikas dhe të integruar të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, në prioritetet e ERE-s, përfshihet edhe zhvillimi i një reforme tarifore nisur nga riorganizimi i tregut, për qëllim të së cilës parashikohet, analiza e problematikave të konstatuara pas miratimit të metodologjive dhe adresimi i zgjidhjeve përmes praktikave më të mira, realizimi i një studimi në mënyrë që të vlerësohen mundësitë që çojnë në uljen e kostove për konsumatorët dhe mbështesin tranzicionin drejt liberalizimit të plotë etj. Lidhur me realizimin e market coupling Shqipëri–Kosovë, ERE angazhohet të luaj një rol të rëndësishëm duke aprovuar bashkëpunimin dhe marrëveshjet operationale të propozuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a) dhe Bursa e energjisë.
- ERE do të vijojë e thellojë angazhimin me organizatat dhe institucionet evropiane, duke e konsideruar bashkëpunimin me to, si një ekspertizë të mirë, për të ndihmuar në sigurimin e rezultateve pozitive për konsumatorët.
- Në vijim do të miratohet edhe kalendari i veprimeve dhe strukturave përgjegjëse për implementimin e Objektivave Strategjik.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

### **Vendosi:**

1. Të miratojë Objektivat Strategjike të ERE për periudhën 2021 – 2023. (bashkëlidhur)
2. Ngarkohet çdo strukturë e ERE-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**

# OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË ERE PËR PERIUDHËN 2021 - 2023

Me këtë dokument, Enti Rregullator i Energjisë, në vijim ERE, adreson objektivat strategjike dhe aspektet kryesore të veprimtimit për periudhën 2021 - 2023 në kuadër të dinamikës së zhvillimit të sektorit në kontekstin kombëtar, si dhe atë të integritimit rajonal.

## Kapitulli I

### 1- Misioni dhe objektivat e përgjithshëm

Veprimtaria e ERE në fushat objekt i rregullimit, drejtohet nga qëllimet e përgjithshme të përcaktuara sipas ligjeve nr. 43/2015 dhe atë nr. 102/2015. Në kuptim të këtyre ligjeve, ERE është përgjegjës për “*Rregullimin e sektorit të Energjisë Elektrike dhe atë të sektorit të Gazit natyror*”. Rregullimi kryhet nga ana e ERE-s, përmes miratimit të akteve nënligjore normative apo individuale që rregullojnë veprimtarinë e subjekteve të sektorit. Rregullimi, përfshin edhe vendosjen në tregun e rregulluar të një sistemi tarifor të besueshëm, transparent e të bazuar në kriteret e paracaktuara në ligj, duke mbajtur në konsideratë interesat e konsumatorëve, si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore që sigurojnë një furnizim të vazhdueshëm kundrejt kostove të drejta dhe të argumentuara. Në përcaktimin e tarifave, ERE duhet gjithashtu “*të harmonizojë objektivat ekonomiko-financiare*” të subjekteve që ushtrojnë aktivitetet të rregulluar, me objektivat e përgjithshme të sektorit në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit apo politikës shtetërore lidhur me zhvillimet sektoriale.

Një aspekt tjetër i rregullimit përfshin funksione monitoruese përmes kontrollit të të licencuarve dhe vendosjes së masave që synojnë të garantojnë pajtueshmërinë e operimit të të licencuarit me rregullat në fuqi. Qëllimi është të mbrojmë dhe të kemi një impakt pozitiv për të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike apo gazit natyror. Për këtë fokusohemi në punën për të promovuar sigurinë e furnizimit dhe qëndrueshmërinë për të tashmen, po ashtu dhe të ardhmen. Për të realizuar këtë objektiv ushtrojmë rregullimin dhe implementimin e skemave mbështetëse, si dhe mbikëqyrjen e tregut. Në punën e saj, ERE bashkëpunon me aktorët kryesorë të sektorit, duke mbajtur të pa cënuar pavarësinë institucionale të Entit si një qëllim i shenjtë i punës së rregullatorit. Sa më sipër kryhet brenda një kornize ligjore të përcaktuar në ligjet që rregullojnë veprimtarinë e ERE në sektorin e energjisë elektrike apo dhe atë të gazit natyror.

Ndër objektivat kryesor të ERE është mbrojtja e interesave të konsumatorëve, në lidhje me shërbimet e rregulluara të ofruara nga operatorët e sektorit. ERE kryen funksionet e saj në vlerësim të çuarjes përpara të objektivave të përcaktuar në ligj, duke promovuar konkurrencë efektive dhe transparente midis pjesëmarrësve të tregut. Në metodologjinë e punës së ERE për të kryer funksionet e saj për qëllime të promovimit të konkurrencës, ERE mban në konsideratë shkallën në të cilën interesat e konsumatorëve duhet të mbrohen si rrjedhojë e ushtrimit të këtyre funksioneve, si dhe nëse ato do të promovojnë ose jo transparencën në veprimtarinë në treg.

Në përcaktimin e Objektivave Strategjike, ERE bazohet në realizimin e qëllimeve të ligjeve të sipërcituara dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, për garantimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët si një shërbim i domosdoshëm në terma ekonomikë, teknikë, e mjedisorë, të shtrirë në të gjithë vendin, dhe i harmonizuar me parimet e objektivat strategjike të vendit.

## Kapitulli II

### 2- KUADRI STRATEGJIK

Kuadri Strategjik paraqitet më poshtë i orientuar në dy drejtime kryesore:

- **Objektivat strategjikë**, në të gjithë aktivitetet e rregulluar të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.
- **Planet e veprimeve** të cilat përshkruajnë masat kryesore që ERE synon të përdorë për realizimin e secilit objektiv strategjik në funksion edhe të një afati kohor dhe me veprime konkrete që afektojnë pozitivisht aktivitetet në keto fusha.

Objektivat strategjikë dhe linjat e veprimit nuk e shterojnë kuadrin e veprimtarive që ERE do të duhet të ndër marrë për rregullimin dhe kontrollin e sektorëve në fushën e saj të përgjegjësisë, por ato përfaqësojnë pikat kryesore në të cilat synohet të ndërhyhet me përparësi, gjithashtu në kontekstin e zhvillimeve sektoriale në vend.

## Kapitulli III

### OBJEKTIVAT STRATEGJIKË PËR VITET 2021-2023

#### 3.1- Mbrojtja e Konsumatorëve përmes ndërgjegjësimit

Prioriteti kryesor i rregullatorëve është “Mbrojtja e interesave të konsumatorëve”, dhe pikërisht konsumatorët janë në thelbin e strategjisë së ERE-s për 2 vitet pasardhëse. Në shoqërinë e informacionit aspekte të rëndësishme të mbrojtjes konsumatore janë jo vetëm tarifa të arsyeshme që reflektojnë kostot e argumentuara por edhe shërbim në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në fushën e informacionit, aspekte të rëndësishme të mbrojtjes konsumatore janë jo vetëm tarifa të arsyeshme, që reflektojnë kostot e argumentuara, por edhe shërbim në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e palëve ofruese dhe marrëse të këtij shërbimi.

Në kontekstin e përgjithshëm të objektivave dhe veprimeve të përshkruara më tej, inovacioni dhe zhvillimi teknologjik (nga të cilat dixhitalizimi përfaqëson një ndër elementët kyç) përbëjnë faktorë të rëndësishëm të evolucionit, i lidhur ngushtë me benefitet që vijnë nga përdorimi i teknologjisë, por i shoqëruar paralelisht edhe me rrezikun e mundshëm të kostove ekstra të krijuara nga ky përdorim teknologjie, çka kërkon vëmendje të vazhdueshme ndaj kostove të shërbimeve.

Në aspektin e kuadrit rregullator ERE është angazhuar për të konsoliduar koherencën e mekanizmave rregullatorë në aktivitetet e ndryshme të fushës së përgjegjësisë së tij. Brenda këtij kuadri, konsumatori merr një rol vendimtar e në rritje. Në këtë kontekst, ndërgjegjësimi i konsumatorit për t'u bërë klient i aftë në vlerësimin e ofertave, kuptimin e drejtë të mekanizmave të tregut, deri në mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë aktive në shërbimet e lidhura me furnizimin, siç është rasti i Vetprodhuesve që prodhojnë dhe konsumojnë vetë energji, merr një rëndësi të veçantë. Ky është një aspekt tjetër i rolit të konsumatorit dhe spektrit të të drejtave e mundësisë së zgjedhjes prej tij jo vetëm të furnizuesit të energjisë, por edhe të kryerjes aktiv të funksionit të prodhuesit/konsumator të energjisë elektrike, duke minimizuar kostot individuale për sigurimin e energjisë elektrike, dhe pse jo, rritjes së rolit të tij në treg. Në këtë aspekt, është me mjaft rëndësi ndërgjegjësimi i konsumatorit për mekanizmat e ndryshëm rregullator, por edhe rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me rolin e tyre të konsumit, në kuadër të lehtësirave që krijojnë proceset e hapjes së tregut në sektor. Nga ana tjetër, rregullimi jo vetëm që duhet të reflektojë një

politikë të qëndrueshme që lejon konsumatorin të bëjë vlerësime, por nga ana tjetër duhet të harmonizojë nevojën për investime në teknologjinë e informacionit me vlerësimin e kujdesshëm të kostove të lidhura me investimet në sektor.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i objektivave që ERE merr në kuadër të rregullimit, por edhe integritit të praktikave bashkëkohore të përdorimit të energjisë elektrike, është ai që lidhet me hapjen e diskutimit publik, si dhe kryerjes së analizave konstatuese mbi impaktin dhe eficiencën e përdorimit të burimeve të tjera të energjisë, si një alternativë ndaj përdorimit të energjisë elektrike me qëllim uljen e impaktit që kjo e fundit ka në mjedis. Novacionet teknologjike gjithmonë e më shumë po ecin në drejtim të maksimizimit të eficiencës për sigurimin e shërbimeve me impakt të ulët në mjedis e kosto më të ulëta. I tillë, por jo i vetëm është edhe përdorimi i energjisë elektrike si një burim energjie për mjetet levizëse të transportit (taksitë, makinat vetjake apo edhe transporti publik).

Energjia është një mall me kosto, e në varësi të të ardhurave të një familjeje, e nevojës për përdorimin e energjisë elektrike, është i një rëndësie të veçantë, sensibilizimi i konsumatorëve mbi racionalizimin e energjisë elektrike. Vendosija e urave të bashkëpunimit mes ERE dhe Agjensive për eficiencën e energjisë elektrike me qëllim sensibilizimin e konsumatorit dhe rritjen e ndërgjegjes kolektive mbi rëndësinë e përdorimit të energjisë elektrike si një produkt i çmuar, i cili nuk duhet të përdoret me efikasitet dhe eficiencë, do të jetë ndër targetat e punës së ERE-s përgjatë tre vjeçarit në vijim.

### **3.2- Dhënia zë konsumatorit**

ERE, në përputhje me objektivat e përcaktuar në ligj, synon të mbështesë dhe promovojë kalimin nga një konsumator pasiv, subjekt i tarifave të rregulluara akteve rregullatore, në një pjesëmarrës aktiv të tregut të energjisë. Hapi i parë në këtë drejtim është duke i siguruar konsumatorit mjete për të kuptuar më mirë nevojat e veta në terma cilësore, në mënyrë që të mund të funksionojë koncepti i pjesmarrjes aktive në treg. Një nga mekanizmat që mund të përdoren për këtë qëllim është fokusimi i punës së ERE në 3 vjeçarin në vijim, në shfrytëzimin më të mirë të mjeteve të informacionit, organizimit të trajnimeve apo tryezave informuese, vënien në eficiencë të numrit pa pagesë në shërbim të konsumatorit, si dhe transparencës sa i përket ligjvënësive në favor të konsumatorëve. Këto mekanizma do t'i shërbejnë ERE edhe në funksion të adresimit, përmes kuptimit të problematikave apo barrierave që konsumatorët konstatojnë dhe arrijnë të vlerësojnë.

### **3.3- Ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe transparenca në vlerësim të shërbimit**

Ndërhyrjet e rregullatorit lidhen kryesisht me zhvillimin dhe përditesimin e një sistemi të menaxhimit dhe trajtimit të ankesave, dhënies së informacionit të saktë e të shpejtë, në kuadër të mundësive të reja teknologjike, që mundesojnë trajtimin në një kohë sa më të shkurtër e me mjete më të thjeshta. Lehtësimin e aksesit për shërbimet e kërkuara në kuadër të zgjedhjes alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM) si një mjet për zgjidhjen e shpejtë të problematikave që normalisht kërkojnë më shumë kohë dhe kosto përmes zgjidhjeve gjyqësore.

Për këtë qëllim, me mjaft rëndësi është edhe vendosja e protokolleve të bashkëpunimit me organizatat e shoqatat që kanë në fokus mbrojtjen e konsumatorëve apo njësitë përgjegjëse në shërbim të konsumatorit pranë pushtetit lokal apo qëndror.

### **3.4- Forcimi i mekanizmave mbështetës për konsumatorët në nevojë.**

Ligji për Sektorin e Energjisë Elektrike ka adresuar në mënyrë të veçantë mbrojtjen e Klientëve në nevojë, në kuadër të sigurimit të një të drejte thelbësore e shumë të rëndësishme, siç është e drejta për të patur energji elektrike. Ky ligj, i cili përcakton ndër objektivat e ERE-s, mbrojtjen e klientëve në nevojë, ka parashikuar, veç të tjerave, detyrimin për furnizuesin e shërbimit universal që të furnizojë në mënyrë të pandërprerë klientët në nevojë, duke respektuar kushtet e përcaktuara në ligj, si dhe kushtet e veçanta që duhen marrë në konsideratë nga ana e ERE-s për të garantuar mbrojtjen e atyre klientëve të energjisë që kanë përfituar këtë status, mbështetur në kriteret dhe procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë, të përcaktuar në aktet ligjore për këtë qëllim.

Energjia elektrike është një shërbim jetësor dhe thelbësor që ndikon në mirëqënien dhe cilësinë e jetës së njerëzve, dhe si të tillë ERE vlerëson se, një aspekt i rëndësishëm i mirëfunksionimit të tregut lidhet me përmbushjen e nevojave specifike për furnizimin me energji elektrike të kategorive të konsumatorëve në rrethana të caktuara. Për këtë qëllim ERE konsideron hartimin e politikave të qarta rregullatore për të adresuar të gjitha sfidat dhe pengesat që lidhen me implementimin e politikave në mbrojtje të konsumatorit në nevojë në sektorin e energjisë elektrike si një target të domosdoshëm për t'u arritur gjatë tre vjeçarit të ardhshëm.

Mbështetja dhe mbrojtja e konsumatorëve është një prioritet kyç i lidhur me përgjegjësitë e Entit. Vizioni është që të mundësojmë një treg të energjisë për të gjithë konsumatorët duke përfshirë edhe konsumatorët në nevojë. Puna dhe detyrat e ERE-s në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë do të kërkojnë një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe aktiv me institucionet përgjegjëse për politikën e mbrojtjes së konsumatorëve në tërësi. Megjithatë Ligji nuk ia adreson ERE përcaktimin e konsumatorëve në nevojë dhe kriteret e përfitimit të statusit të klientit në nevojë, në rolin e tij si rregulator i sektorit, roli i ERE-s është tejet i rëndësishëm në krijimin e kushteve për mundësinë e furnizimit të tyre në mënyrë të vazhdueshme dhe me cilësi.

Aktet nënligjore të miratuara nga ERE, kanë adresuar rrethanat e ndërprerjes së energjisë elektrike për klientët në nevojë që rezultojnë debitorë. Në vijim, në fokus të punës së ERE mbetet ndërmarrja e aktiviteteve të pajtueshmërisë dhe zbatimit për të siguruar që të licencuarit që ofrojnë shërbim furnizimi, të kenë vëmendjen e nevojshme dhe kujdesin që aktiviteti i tyre të jetë në përputhje me konceptet e mbrojtjes të konsumatorëve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

## **Kapitulli IV**

### **PLANI I VEPRIMEVE**

#### **4.1- Aktivizimi i konsumatorit**

Në kuadër të bashkëpunimit me shoqatat dhe organizatat, që në objekt të veprimtarisë së tyre kanë mbrojtjen e konsumatorëve do t'i kushtohet vëmendje e veçantë promovimit të transparencës e qartësisë në dialogun me konsumatorët, duke përmirësuar të gjitha kanalet aktuale të komunikimit nga ana e ERE-s, që lejojnë një mënyrë më efektive për përhapjen e njohurive për të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve e që forcojnë shkallën e tyre të besimit, nëpërmjet vendosjes së një marrëdhënie të drejtpërdrejtë dhe inovative me një audiencë sa më të gjerë duke shfrytëzuar nga njëra anë, mundësitë teknologjike, por duke vijuar me mjetet tradicionale, për ata konsumatore që kanë nevojë për të.

Zhvillimi i një Portali të Konsumatorit, i cili të jetë aktiv e në dispozicion të këtij të fundit, në përputhje dhe me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe që ofron shërbim mbi të dhënat historike të konsumit të tij përmes Sistemit të Informacionit të Integruar me Operatorin përgjegjës për rregjistrimin e konsumit të energjisë, të klientëve.

Realizimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere që synojnë të përmirësojnë ndërgjegjësimin e konsumatorit/përdoruesit mbi funksionimin dhe rregullimin në fushat e kompetencës së ERE.

#### **4.2- Ndërgjegjësimi për konsumatorët dhe transparencë për vlerësim të shërbimit**

Veprimet për qëllim të këtij objektivi, përfshijnë ndjekjen e praktikave më të mira ndërkombëtare në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për të ndihmuar në zgjidhjen e tyre. Një analizë e praktikave rajonale do të shërbente përditësimit të këtyre rregullave në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Kjo analizë do të përfshijë ndër të tjera studimin mbi përmirësimin e procedurave ekzistuese të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, krijimit të një strategjie për të mbështetur një komunikim efektiv duke u angazhuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes konsumatorëve dhe të licensuarve, në mënyrë interaktive me ERE-n dhe këtyre të fundit.

Qasja rregullatore për tregun e energjisë është siguri se opinioni i konsumatorëve, apo dhe nevojat e tyre aktuale dhe të ardhshme janë marrë në konsideratë në çdo rast që ka patur apo ka nevojë për rregullim.

Për këtë qëllim praktikat rregullatore do të vijojnë të përfshijnë zhvillimin e seancave dëgjimore dhe konsultimeve mes palëve, për një gjykim të drejtë të problematikave të ngritura dhe zgjidhjeve respektive të tyre.

Furnizimi i energjisë konsiston kryesisht në ofrimin e shërbimit në mënyrë cilësore dhe me standarde të tij. Për këtë qëllim, ERE do të përgatisë treguesit e matjes dhe vlerësimin të performancës së shërbimit ndaj Klientit që garanton çdo i licensuar në furnizim.

Këta tregues do të përcaktojnë nivelin e kënaqësisë së klientit ndaj shërbimit të ofruar, parë në këndvështrimin e të gjitha aspekteve të marrëdhënies së tij me ofruesin e shërbimit. Sa më sipër lidhet me kushtet e garantimit dhe zbatimit të një kontrate furnizimi dhe më tej aspekte të tilla si vlerësimi i konsumatorit mbi procedurat dhe afatet për lidhjen e një kontrate, ndryshimin e furnizuesit, emetimin e faturave në afat, trajtimin dhe zgjidhjen së ankesave nga ana e ofruesit të shërbimit dhe garantimi i aksesit në të dhënat vetjake që lidhen me konsumin e energjisë.

Paralelisht do të vendosen dhe monitorohen rregullisht standardet e cilësisë së shërbimit. Për këtë qëllim do të vijohet me përcaktimin e kritereve të standardeve të cilësisë në përputhje me rregulloren për cilësinë e shërbimit, si dhe përditësimin e tyre periodik mbështetur në të dhënat e gjeneruara përgjatë një viti kalendarik si dhe pritshmërinë e vlerësimit të shërbimit të cilësisë së shërbimit, të investimeve të propozuara dhe miratuara për ofruesit e shërbimit publik, kjo bazuar dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Po ashtu do të zhvillohet dhe çdo formë tjetër përfshirje për qëllime të marrjes së opinionit të konsumatorëve për të kuptuar më mirë objektivat e tyre në të ardhmen dhe atë që konsumtarët presin nga ERE.

### **4.3- Forcimi i mekanizmave mbështetës për konsumatorët në nevojë.**

Adresimi i zgjidhjeve për një furnizim të qëndrueshëm të konsumatorëve në nevojë kërkon veprime të përbashkëta ndërmjet qeverisë, rregullatorit dhe pjesëmarrësve të tjerë të sektorit të energjisë. Vulnerabiliteti është një çështje komplekse për të trajtuar ku të gjithë politikëbërësit, grupet e interesit, organizmat apo shoqatat me fokus konsumatorin, si dhe ofruesit e shërbimeve duhet të bashkëpunojnë për të adresuar sfidat që lidhen me këtë kategori.

Një vëmendje e veçantë do të kushtohet bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse për politikën e mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë. Për këtë qëllim do të vijohet komunikimi me institucionet përgjegjëse për vendosjen e kriterëve të përcaktimit të klientëve në nevojë.

Në përputhje me zhvillimet e këtyre politikave synohet përditësimi i akteve rregullatore që lidhet me sigurimin me cilësi të furnizimit me energji elektrike të këtyre konsumatorëve. Nisur nga praktikat më të mira rajonale dhe më gjërë, nga ERE do të përgatiten edhe propozimet e nevojshme për të shtyrë përpara iniciativat ligjore, për rregullimin e kuadrit ligjor plotësues për këtë kategori, në rolin e një aktori më aktiv në drejtim të kompetencave rregulluese për këtë kategori konsumatorësh.

Për këtë qëllim, kryerja e një studimi lidhur me politikat më të mira rregulluese për mbrojtjen e klientëve në nevojë në vendet e BE-së, do të shërbejë për të propozuar pranë institucioneve kompetente ndryshimet e nevojshme në aktet ligjore dhe nënligjore, përfshirë ndryshimet e nevojshme me aktet rregullatore të ERE. Sfidë më vete në drejtim të politikave të mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë është aspekti i shmangies së ndër-subvencioneve dhe rolit që duhet të luajmë për rishpërndarjen e kostove në grupe të ndryshme të konsumatorëve, apo edhe në nevojën për aplikimin e politikave që lidhen me eficiencën në energji.

Në kuadër të studimit për ndryshimet e nevojshme në kuadrin rregullator po ashtu vëmendje e veçantë do të kushtohet dhe aspekteve që lidhen me barrierat me të cilat përballen këta konsumatorë në krahasim me klientët e tjerë. Eksperienca ka treguar se konsumatorët në nevojë mund ndihen të paafte për të marrë vendime që lidhen me furnizimin në energji. Studimi i barrierave mund të përfshijë bashkëpunimin edhe me organet përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit apo me shoqatat e konsumatorit. Klientëve në nevojë duhet t'u sigurohet mbështetje edhe nga organet përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit apo shoqatat e konsumatorëve, si edhe ndërgjësimi i të licensuarve apo pjestarëve të tregut për hartimin e politikave brenda kompanive lidhur me mënyrën se si ata projektojnë dhe realizojnë shërbimet e tyre për klientët në nevojë.

Hartimi i një Programi të Mbrojtjes së Konsumatorëve do të shërbente për të siguruar njohuri të mjaftueshme dhe të vazhdueshme në politikat mbështetëse për konsumatorët.

## **Kapitulli V**

### **5.1- Zhvillimi i tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit natyror gjithnjë e më efikas dhe të integruar.**

ERE do të përqëndrohet në punën e saj ndër të tjera, në promovimin e konkurrencës dhe inovacionit me qëllim uljen e çmimeve dhe në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve;

Mbështetur kjo, ne sa më poshtë:



- parimi i hapjes së tregut - përdorimi i mekanizmave të tregut kudo që është e mundur për të përfituar plotësisht nga inovacioni dhe konkurrenca;
- parimi i koherencës - rregullim efikas dhe i përgjegjshëm ku është e mundur që shfrytëzon mundësitë e mëdha të ekonomisë dixhitale (smart); dhe
- parimi i shpërndarjes së drejtë - konsumatorët e të gjitha llojeve duhet të paguajnë një pjesë të drejtë të kostove të sistemit në përputhje me shërbimin që marrin dhe kostot që shkaktojnë.

Në këtë drejtim prioritetet e ERE gjatë kësaj periudhe do të jenë:

• Zhvillimi i një reforme tarifore nisur nga riorganizimi dhe hapja e tregut.

- Për këtë qëllim është e nevojshme një analizë e plotë e problematikave të konstatuara pas miratimit të metodologjive dhe adresimi i zgjidhjeve përmes praktikave më të mira ndërkombetare në këtë drejtim. Për këtë qëllim, do të përdoren raportet, studimet e kryera nga donatorët apo dhe organizatat rajonale ku ERE aderon.
- Realizimi i një studimi në mënyrë që të vlerësohen mundësitë që çojnë në uljen e kostove për konsumatorët dhe mbështesin tranzicionin drejt liberalizimit të plotë.
- Analizë të detajuar mbi një vlerësim se si rregullimi ndikon në grupe të ndryshme të konsumatorëve; dhe
- Zhvillimi i mënyrave efektive të vendosjes së bazës së rregulluar të aseteve (RAB)

Nevoja për të lejuar një pjesëmarrje gjithnjë e më të gjerë aktive të pjesëmarrësve të tregut me transaksione të orientuara në tregun e ditës në avancë dhe intraday do të duhet të gjejnë zgjidhje, në mënyrë që të përfshijnë kostot e sistemit në lidhje me shërbimet e ofruara në treg.

Objektivi i kësaj strategjie synon të sigurojë që politikat rregullatore, mekanizmat dhe praktikat operacionale do të zbatohen në përputhje me praktikën më të mira rregullatore dhe dispozitat e zbatueshme të legjislacionit të Komunitetit të Energjisë, si dhe Kodet e zbatueshme të Rrjetit.

Enti Rregullator i Energjisë, miraton rregullat dhe rregulloret e nevojshme për të përmbushur detyrimet sipas Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror të vitit 2015, i ndryshuar. ERE lëshon licencat për operimin e aktivitetëve në fushën e gazit natyror. Përcakton tarifën dhe çmimet në përputhje me kushtet e Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror të vitit 2015. Monitoron, kontrollon dhe siguron pajtueshmërinë me kushtet, ligjet dhe licencat.

Siguron mbrojtjen e konsumatorit në lidhje me tarifën.

Sa i përket sektorit të gazit natyror, ERE ka marrë masat e nevojshme për draftimin e kuadrit të plotë ligjor që faciliton operimin në këtë sektor, pavarësisht se aktiviteti në sektorin e gazit në Shqipëri është në stadin foshnjor. Në objektivat afatgjatë 3 vjeçarë të ERE do të jenë:

1. Identifikimi i nevojës dhe kërkesave për gaz dhe skenarët e mundshëm për të mundësuar furnizimin me gaz të konsumatorit shqiptar, qoftë ai familjar apo edhe jo familjar.
2. Studimi i Politikave të çmimeve, tarifave dhe implementimit të rregulloreve të gazit të miratuara nga ERE dhe jo vetëm
3. Zhvillimin e njohurive dhe aftësive brenda Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për të identifikuar në kohe mundësinë për rregullim dhe ndërhyrje aty ku është nevojë,
4. Adresimi i çështjeve që lidhen me kuadrin institucional kombëtar të sektorit të gazit, dhe dhënia e rekomandimeve për zhvillimin e mëtejshëm të tij, si dhe mbështetja në zhvillimin

e njohurive në fushën e gazit dhe aftësimin profesional të punonjësve të ERE nëpërmjet trajnimeve të targetuara për specifikat e zhvillimit të këtij sektori në Shqipëri.

5. Vlerësimi i rrejtësive ekzistues të gazit në Shqipëri, dhe dhënia e rekomandimeve për integrimin e tij të mundshëm në sistemin e ardhshëm kombëtar të gazit;

## **5.2- Integrimi rajonal**

Memorandumi i Mirëkuptimit të WB6, i nënshkruar më 27 Prill 2016, në Vjenë nga 6 vende përfshirë Shqipërinë dhe Kosovën. Në kuadër të këtij Memorandumi në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, rregullatorët do të përdorin autoritetet e tyre për:

- Të hequr pengesat rregullatore dhe monitorojnë zhvillimin e vazhdueshëm në nivel teknik dhe rregullator.
- Të miratojnë procedurë të përbashkët dhe efikase të vendimmarrjes, që do të ndihmojnë në krijimin e mundshëm dhe të duhur të Bursës (PX).

Ligji Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë”, i ndryshuar, përcakton ERE-n në cilësinë e Autoritetit përgjegjës për garantimin e promovimit të konkurrencës dhe efikasitetin në sektor. Modeli i Tregut i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.07.2016, thekson ndër të tjera se, Shqipëria është e angazhuar të zbatojë një sërë masash afatshkurtra, në kuadrin e procesit të Berlinit (Ballkani Perëndimor 6). Modeli i tregut synon të mbështesë zbatimin e angazhimeve të ndërmarra në kuadrin e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe rregulloret përkatëse. Ky model synon ndër të tjera të sigurojë një strukturë të qëndrueshme dhe të krijojë kushtet për integrimin e mëtejshëm rajonal, midis Shqipërisë dhe vendeve fqinje. Mekanizmi i Bashkimit të Tregut është pjesë e projektit Evropian për krijimin e Tregut të Brendshëm të Energjisë për të rritur efikasitetin e tij.

Aktualisht nën asistencën dhe mbështetjen e USAID janë hedhur hapa të rëndësishëm në kuadër të bashkimit të tregjeve ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

Në vijim puna e rregullatorit do të fokusohet ndër të tjera në:

- Kontrollin dhe azhurnimin e legjislacionit në fuqi nëse ka pengesa ligjore në procesin e bashkimit të tregut, përfshirë bashkëpunimin për licencimin në tregjet reciproke, operimin e pjesëmarrësve në treg, alokimin e kapacitetit ndërkufitar përmes ankandit eksplícit apo dhe zbatimit të praktikave më të mira ndërkombëtare në këtë drejtim.
- Mbështetjen për zbatimin e rregullave teknike për operimin e tregjeve të përbashkëta nga të dy TSO-të.
- Përpilimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve midis OST-ve dhe Rregullatorëve për implementimin e bashkimit të tregjeve.
- Nominimin e NEMO-s për operimin e të dy tregjeve në përputhje me kushtet e nominimit, si dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

## **5.3- Forcimi i aksesit në informacion për funksionimin korrekt të proceseve të tregut.**

ERE në përputhje me kompetencat rregullatore do të fokusojë punën e saj për të mbledhur dhe menaxhuar flukset në rritje të të dhënave që bëhen të disponueshme, dhe në mënyrë më të

dukshme të bazojë metodat e saj analitike dhe vendimmarrjen në baze të këtyre të dhënave. Përdorimi më i mirë i të dhënave do të mundësojë që ERE të veprojë në mënyrë më efektive dhe transparente.

Në këtë kontekst, ERE synon të forcojë angazhimin e saj për integrimin e tregut kombëtar të energjisë në kontekstin rajonal, në koordinim të ngushtë me ministrinë përgjegjëse për energjinë, operatorët e rrjetit, dhe rregullatorët fqinjë duke siguruar transparencën e nevojshme ndaj palëve të interesuara.

Evolucioni i veprimtarisë së operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe asaj të shpërndarjes, si dhe marrëdhënia e tyre me përdoruesit, gjithashtu do të analizohen në kontekstin e shmangies së barrierrave dhe në adresimin në kuadër të miratimit të investimeve, që i shërbejnë cilesisë së shërbimit, por edhe sigurisë së sistemit, i cili në të njëjtën kohë ka përfitimet e veta nga dixhitalizimi, por njëkohësisht është edhe vulnerabël për mbrojtjen nga sulmet kibernetike. Në këtë kontekst ERE do të fokusohet edhe në analizën e nivelit të implementimit të Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike nga operatorët si dhe shtrirjen e saj dhe në sektorin e gazit natyror.

Krahas rregullimit klasik përmes mbikëqyrjes apo përmes përpunimit të të dhënave, është e nevojshme që, në mënyrë progresive të forcohen aktivitetet për monitorimin e sjelljes së operatorëve të tregut, veçanërisht në zbatimin e Rregullores Evropiane REMIT, me qëllim garantimin e kushteve transparente konkurruese dhe luftimin dhe parandalimin e sjelljes abuzive duke identifikuar menjëherë çdo nevojë për të përshtatur vetë rregulloren (edhe për qëllimet e sigurisë së sistemit), si dhe për çdo raport mbi konkurrencën në treg.

Implementimi i REMIT do të bazohet në Kuadrin ligjor dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të orientuar në:

- Detyrimin për të publikuar informacione të brendshme
- Ndalimin e abuzimit të tregut (tregtimi i brendshëm dhe manipulimi i tregut)
- Monitorimin e Tregut (regjistrimi i pjesëmarrësve në treg)
- Mekanizmin e Raportimit të detajuar, mbledhja e të dhënave
- Kompetencat hetimore dhe të zbatimit të penaliteteve të rregullatorit
- Aspekte të tjerë në lidhje me mbrojtjen dhe besueshmërinë e të dhënave
- Lista e kontratave dhe të dhënave që do të raportohen
- Palët përgjegjëse dhe afatet
- Udhëzime, rekomandime
- Njohja e palëve me detyrimet e zbatimit të kësaj rregulloreje
- Bashkeveprimi ndër rajonal për zbatimin e saj në rajon e më gjerë

Pikërisht politikatat rregullatore edhe në vijim do të kenë për qëllim që të sigurojnë qëndrueshmëri ligjore dhe rregullatore për të menaxhuar potencialin për praktika abuzive që dëmtojnë në mënyrë të padrejtë tregun.

Brenda vitit 2021 synohet të realizohet procesi i konsultimit të draftit të Rregullave për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT) të cilat do të hyjnë në fuqi dhe do të jenë të detyrueshme për tu zbatuar brenda tremujorit të parë të vitit 2021.

## KAPITULLI VI

### PLANI I VEPRIMEVE PËR ZHVILLIMIN E TREGJEVE

#### **6.1- Racionalizimi dhe thjeshtimi i rrjedhës të informacionit për të vlerësuar funksionimin e proceseve të tregut**

Qëllimi është të përfundojnë reformat që synojnë racionalizimin dhe thjeshtimin e flukseve të informacionit i cili garanton funksionimin e duhur të tregjeve dhe marrja e informacionit sa më të thjeshtuar për konsumatorin. Në këtë kontekst është e nevojshme të përfundohen reformat e proceseve tregtare që kanë të bëjnë me të drejtën për ndryshimin e furnizimit dhe administrimit të procedurave të ndërhyrjes në rast të borxheve midis palëve, si dhe ndërhyrjet rregullatore në fushën e menaxhimit të të dhënave në lidhje me përdorimin e të dhënave të klientëve fundorë të përpunuara nga operatorët e rrjetit.

Për këtë do të analizohen të dhënat lidhur me detyrimet e raportimit, metodat dhe kohën e vënies së tyre në dispozicion, përdorimi i të dhënave për palët e interesuara dhe, në veçanti për pjesëmarrësit e tregut. Në këtë kontekst në përputhje me gjetjet gjatë vitit 2021, në vijim në vitin 2023 do të përpunohen edhe propozimet për ndryshimet e nevojshme në aktet rregullatore. Sa më sipër do të jetë produkt i vlerësimit të kornizës rregullatore që identifikon çdo pengesë në legjislacionin primar dhe atë sekondar për të vendosur mbi ndryshimet e mundshme atje ku vlerësohet e nevojshme.

Në po këtë prizëm, rregullatori do të shërbejë dhe si një ndërfaqe për dhënien e informacionit të nevojshëm për konsumatorët dhe mundësitë që ofrojnë furnizuesit në mënyrë që konsumatori të ketë një panoramë të qartë të mundësive që i ofrohen, përfshirë këtu çmimet dhe cilësia me të cilën këto shërbime ofrohen, si dhe detyrimet që ka ndaj kontratës së furnizimit me ofruesit e këtij shërbimi.

#### **6.2- Realizimi i bashkimit të tregjeve Shqipëri -Kosovë**

Bashkimi i tregut midis Shqipërisë dhe Kosovës filloi nën një qasje vullnetare. Qeveritë e të dy vendeve janë përfshirë që në fillim për të mbështetur projektin. Rregullatorët do të luajnë një rol të rëndësishëm duke nxitur marrëveshjet e bashkëpunimit dhe marrëveshjet operationale të propozuara nga ana e TSO-ve, OST dhe PX.

Gjithashtu do të jetë në fokus ndër të tjera dhe:

- Identifikimi se cilat pjesë të CACM mund të transpozohen në kornizën ligjore aktuale
- Kontrolli nëse ka pengesa ligjore në legjislacionin kombëtar që pengojnë ose vonojnë bashkimin e tregjeve
- OST dhe PX përgjegjës për zbatimin e iniciativës dhe trajtimin e fazës operationale.

Më tej do të punohet në drejtim të zgjerimit të integritetit duke ftuar rregullatorët e tjerë të Ballkanit për t'u bashkuar në projektet në kaudër të WB6.

### **6.3- Forcimi i aksesit në informacion për funksionimin korrekt të proceseve të tregut.**

ERE gjithmonë ka vlerësuar aksesin në informacion dhe transparencën si kritike për arritjen e misionit dhe qëllimit të saj, politikë e cila qëndron në themel të praktikave të vendimarrjes. ERE ka funksionuar gjithmonë si një organ publik i hapur duke publikuar vendimet e saj, pa shmangur paralelisht edhe detyrimet për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe privatësisë. Vendimet e ERE janë thjeshtësisht të aksesueshme nëpërmjet faqes së internetit, por edhe nëpërmjet publikimit në Fletoren Zyrtare.

Përdorimi i Teknologjive të reja vlerësohet si një nga mjetet për të çuar edhe më tej praktikën e një organi të hapur ndaj publikut dhe palëve të interesuara. Në këtë drejtim, është në fokusin e ERE duke amplifikuar këtë politikë në kuadër të hartimit të një strategjie të Digjitalizimit që shërben si një bazë për të ndihmuar në krijimin e një kulture ku të dhënat luajnë një rol të madh në vendimet rregullatore. Për këtë qëllim është e rëndësishme të sigurohet në vijimësi :

- Aksesit i rregullatorit në të dhëna, në mënyrë që të prodhojnë vendime, të garantuara nga ky informacion.
- Aplikimi i teknologjisë në praktikën rregullatore, duke ofruar shërbime të klientëve dhe më efektive, duke shfrytëzuar platforma të përbashkëta për të përmirësuar shpërndarjen e informacionit në të gjithë aktorët e tregut të energjisë me synimin që të mundësojë shpërndarjen më efektive dhe të koordinuar të informacionit digjital në të gjithë sektorin ku ERE është marrës por dhe burim informacioni për tregun. Plani i veprimit në këtë drejtim përfshin edhe shfrytëzimin e mundësive për të blerë pajisjet, aplikacionet digjitale mbi përpunimin e të dhënave.

## **KAPITULLI VII**

### **VLERËSIMI I NDIKIMIT RREGULLATOR**

#### **7.1- Transparenca dhe integriteti në veprimtarinë administrative.**

Ne studimin e Organizatës për zhvillim dhe bashkëpunim ekonomik (OECD), vlerësohet se është e rëndësishme që rregullatorët të jenë të vetëdijshëm për ndikimet e veprimeve dhe vendimeve të tyre rregullatore. Një indeks matës për shumë rregullatorë mund të jetë koha e përpunimit të akteve rregullatore ose vendimeve të tjera. Vonesat e panevojshme në proceset rregullatore që mund të imponojnë kosto shtesë për biznesin dhe komunitetin, dhe kështu rregullatorët duhet të përshpejtojnë kohën e tyre të përpunimit për vendimet kryesore në kuadër të standardeve të përcaktuara.

ERE është një organ administrativ i pavarur, në përputhje me ligjin për energjinë dhe Gazin Natyror, që ushtron kompetencat me paanësi dhe transparencë.

Është parimi i konsoliduar në veprimtarinë e ERE, që ushtrimi i kompetencave rregullatore të përfshijë procedura të bazuara në pjesëmarrje, si përmes konsultimit të personave, ekspertëve të fushës, ashtu edhe në drejtim të grupeve të gjëra të interesit. Sa më sipër është vlerësuar si një aspekt i rëndësishëm i llogaridhënies duke informuar mbajtesit e interesave në treg në mënyrë adekuate dhe mbledhjen dhe marrjen e mendimeve, opinionëve dhe propozimeve.

#### **7.2- Plani i veprimit konsiston në:**

Përfshirja e palëve të interesuara në përcaktimin e strategjive, politikave rregullatore, jo vetëm duke u siguruar që të dëgjohen, por edhe duke siguruar angazhimin për të siguruar një raport të aktiviteteve për angazhimin e tyre periodik mbi ndikimin e akteve rregullatore.

Për këtë qëllim do të vleresohen edhe praktikave më të mira për ngritjen e strukturave konsultative të përhershme të tillë si komisione të përbashkëta të palëve të interesit që do të shërbejnë vendimarrjes.

Vendosja e indikatorëve të performacës për vlerësim nga vetë rregullatori përbën një element kyç dhe mjaft i rëndësishëm i kësaj strategjie.

### **7.3- linjat e veprimit**

**Në këtë drejtim identifikohen linjat e veprimit si vijon:**

Transparenca e vendimarrjeve,

- Publikimi i vendimeve, relacioneve dhe aplikimeve.
- Verifikimin ex post i ndikimit të rregullores.
- Studim i praktikave më të mira për vlerësimin e efekteve të rregullimit me mbështetje nga ekspertë akademikë dhe ekspertë të tjerë me përvojë në fushë.

Të gjitha këto lejojnë rregullatorin që nga njëra anë të kuptojë përgjigjen e operatorëve apo palëve të tjera të interesit, ndaj ndërhyrjeve të rregullatorit nga ana tjetër për të zbatuar çdo veprim korrigjues pas hetimeve, analizave e zbulimit të fakteve, kontrolleve dhe inspektimeve e dokumenteve që lidhen me zbatimin e këtyre akteve. Për këtë qëllim, ERE do të vijojë të kryejë anketime për të vlerësuar ndikimin rregullator.

ERE është e fokusuar për të krijuar një kornizë analitike për të vlerësuar vazhdimisht ndikimin e politikave tona për grupe të veçanta të konsumatorëve në situata të ndryshme. Për këtë, do të përqendrohemi në hartimin e një kornize rregullatore për kriteret e vlerësimin e ndikimit të parimeve të Rregullatorit.

Kjo kornizë rregullatore do të përdoret, për të kuptuar ndikimin e politikave tona për grupe të veçanta të konsumatorëve që mund të jenë në situata vulnerabël.

Qëllimi jonë është që kur marrim vendime, ta bëjmë këtë në një mënyrë që më së miri mbron interesat e konsumatorëve ekzistues dhe të ardhshëm, çka përfshin balancimin e përfitimeve të çdo veprimi që marrim kundër kostove që mund të lindin për shkak të këtyre vendimarrjeve.

### **7.4- Promovimi i zvogëlimi të barrierave rregullatore dhe shkurtimi i kohës së procedurave rregullatore.**

Ka disa pengesa për konsumatorët që të bëjnë zgjedhje të mira në tregun aktual të energjisë, duke përfshirë mos njohjen e opsioneve në dispozicion të tyre dhe mungesa e informacionit të plotë e kompleks nga shoqëritë e licencuara që ushtrojnë aktivitet. Kuptimi i këtyre pengesave, dhe sjellja e konsumatorëve dhe kompanive në përgjigje të tyre, merr një rëndësi të veçantë.

Kuadri rregullator duhet t'u mundësojë investitorëve dhe konsumatorëve që të maksimizojnë mundësitë. Në një treg me pakicë të përqendruar, duhet të menaxhojmë ato shërbime universale dhe detyrime të tjera sociale dhe mjedisore, me qëllim garantimin e një tregu konkurrues ku

infrastruktura qëndrore e teknologjisë dhe standardeve që mbështesin tregun me pakicë të shërbejë si një mekanizëm për rritjen e ndershme të konkurrencës midis furnizuesve për të mbajtur kosto të ulëta për furnizim.

ERE do të marrë përsipër një numër aktiviteteve me qëllim që të sigurohet që tregu të punojë në mënyrë efektive. Këto përfshijnë mbikëqyrjen e rregullave, monitorimin e aktivitetit të tregut dhe të mundësive të abuzimit në treg. Në veçanti, analiza do të përfshijë shqyrtimin nëse tregu i energjisë elektrike po punon për të siguruar transaksione efektive të tregtisë apo nëse është e nevojshme reforma e tregut për të lejuar mënyra më efektive për të tregtuar duke lejuar përdorimin më efikas të energjisë dhe zvogëlimin e kostove.

## **Kapitulli VIII**

### **Përditesimi i kuadrit rregullator**

#### **8.1- Promovimi i rregullave në përputhje me zhvillimin e kuadrit ligjor të Komunitetit të Energjisë dhe në vlerësim të specifikave të sistemit energjistik në vendin tonë.**

Shqipëria ka nënshkruar Traktatin e Komunitetit të Energjisë, i cili mbulon një sërë fushash në lidhje me marrëdhëniet e Shqipërisë dhe BE-së, duke përfshirë energjinë. Ky traktat vendos disa shtylla në lidhje me sigurinë e furnizimit, efikasitetin e energjisë së rinovueshme dhe statistikat si dhe përafrimin me kuadrin rregullator të vendeve të rajonit me ato të BE-së.

Pikërisht në përputhje me angazhimet e vendit në kuadër të integritimit evropian, ERE do të vazhdojë të punojë me qeverinë dhe aktorët e tregut të energjisë, në vend dhe në Evropë, për të siguruar që korniza rregullatore të jetë në përputhje me detyrimet që lindin nga ky angazhim. Një nga pjesët më të rëndësishme të legjislacionit të BE-së për tregjet e gazit evropian dhe të energjisë elektrike është paketa e tretë e përbërë nga tre rregullore dhe dy direktiva. Një nga synimet kryesore të paketës së tretë ishte liberalizimi i tregut të energjisë, caktimi i autoritetit kombëtar rregullator të energjisë (NRA) të pavarur, përgjegjës për rregullimin e tregut të energjisë në vend. Një nga aspektet kryesore të paketës së tretë është që të sigurohet që operatorët e sistemit të transmetimit (OST) të jenë të ndara (ose të pavarura) nga interesat e prodhimit, dhe furnizimit dhe të jenë të certifikuar si të tilla.

ERE tashmë ka miratuar certifikimin e pajtueshmërisë së OST-së në përmbushje të kërkesave ligjore, proces i cili është në monitorim të vazhdueshëm nga ana e ERE-s.

Përveç kësaj, paketa legjislative inkurajon investime afatgjata duke kërkuar Entso-G dhe Entso-E përditësimin e planeve dhjetëvjeçarë të zhvillimit të rrjetit çdo dy vjet. Kjo politikë është reflektuar në rregullore e miratuar nga ERE për miratimin e planit të investimeve të OST sh.a.

Fokus për punën tonë dhe një element kryesor i paketës së tretë, është kërkesa për të siguruar që konsumatorët të mbrohen. Paketa e tretë përcakton detyrimet për furnizuesit që kanë të bëjnë me çështje të tilla si: Faturat e konsumatorëve, Përmbajtja e kontratave të furnizimit, Kohën dhe kohëzgjatjen në të cilën të dhënat e furnizimit duhet të ruhen, kohën që duhet të marrë një konsumator për të ndryshuar furnizuesin, etj. Paketa e tretë krijoi një kuadër rregullator për të

mbështetur një treg të vetëm evropian të energjisë duke zhvilluar kodet e rrjetit evropian. Kodet e rrjetit do të formojnë një grup të detyrueshëm ligjor të rregullave dhe detyrimeve të përbashkëta teknike dhe tregtare që rregullojnë qasjen dhe përdorimin e Rrjeteve Europiane të Energjisë. Kodet e rrjetit kanë qenë dhe do të zhvillohen në mekanizmat e alokimit të kapaciteteve, balancimin e energjisë, strukturat tarifore të transmetimit dhe ndërveprimin e palëve.

ERE ka punuar ngushtë me palët e interesit duke diskutuar opinione gjatë hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore që përbëjnë kuadrin rregullator të sektorit dhe që mbrojnë konsumatorët.

## **8.2- Masat rregullatore**

Masat që do të merren nga ERE do të jenë;

- Ndryshime të nevojshme në rregulloret dhe procedurat e licencimit për njohjen reciproke të licencave,
- Angazhimi me operatorët mbi administrimin e kodeve të rrjetit,
- Angazhimi me aktoret brenda vendit dhe organizmat europiane apo dhe me homologë për plotësimin e kuadrit rregullator.
- Bashkëpunim ndërinstitucional dhe me institucionet europiane të lidhura me mekanizma që promovojnë një treg eficient dhe të qëndrueshëm.

Ne do të punojmë që qasjet tona rregullatore të mbështesin një treg konkurrues me përfitime për konsumatorët dhe që nuk çënon interesat e ligjshme të tyre.

Po ashtu do merren masat e ligjshme dhe të rregullave në vend për të siguruar që ne kemi një regjim të fuqishëm rregullator që punon me fokus për konsumatorët dhe promovon hapjen e tregut.

Praktikat rregullatore do të vijojnë të kenë fokus bashkëpunimin me pjestarë të tjerë dhe të kenë një kuadër rregullator transparent dhe efektiv.

## **Kapitulli IX**

### **Bashkëpunimi me institucionet e tjera për çështje rregullatore, për një zhvillim të qëndrueshëm**

#### **9.1- Shtrirja e bashkëpunimit**

Objektivat strategjikë të përshkruar më sipër kërkojnë bashkëpunim të ngushtë me organet e tjera. Duke pasur parasysh natyrën radikale të ndryshimeve në perspektivë dhe kërkesat e tyre për legjislacion të ri, është veçanërisht e rëndësishme bashkëpunimi i ngushtë me institucionet e tjera. ERE e konsideron të rëndësishëm vijimin e bashkëpunimit me ministrinë përgjegjëse për energjinë përmes ekipeve të përbashkëta për një sërë objektivash, duke filluar nga reforma në tregun e shitjes me pakicë te roli i funksionimit të sistemeve/operatorëve.

I një rëndësie të veçantë është dhe bashkëveprimi me institucione të tjera, të tillë si Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike në kuadër të bashkëpunimit për çështjet që lidhen me Zbatimin e masave të plota organizative dhe teknike të sigurisë kibernetike në sistemet e komunikimit dhe të informacionit, Autoritetit të Konkurrencës apo dhe Avokatit të Popullit.



ERE do të vijojë të thellojë angazhimin me organizatat dhe institucionet evropiane, duke e konsideruar bashkëpunimin me organizata të tilla, si një ekspertizë të mirë, për të ndihmuar në sigurimin e rezultateve pozitive për konsumatorët.

Është e qartë që politika që lidhet me sektorin e energjisë është në shumë mënyra ndër-sektoriale, me lidhje të qarta me fushat e politikave të pergjithëshme në vend, të tilla si, çeshjet që lidhen me shërbimet publike, mbështetjen qeveritare për prodhuesit e burimeve të rinovueshme të energjisë, konsumatorët në nevojë apo planet e zhvillimit në vend në tërësi. Prandaj, ne do të vazhdojmë të angazhohemi drejtpërdrejt burimet tona me institucionet politikë bërëse për të siguruar kuptimin e ndërsjellë të objektivave tona përkatëse brenda fushes së përgjegjësisë dhe kompetencës. Bashkëpunimi do të përfshijë edhe mbajtjen e takimeve vjetore të ERE me konsumatorë, organizata, investitorët për t'i dëgjuar pikëpamjet e tyre, por edhe për të promovuar kuadrin rregullator. Në punën tonë rregullatore, ne mbështetemi dhe jemi mirënjohës për bashkëpunime me organizmat e ndryshëm të përfaqesimit të konsumatorëve, por edhe të pjesëmarrësve të tjerë të tregut në mënyrë të veçantë në drejtim të proceseve konsultuese që ERE zhvillon me qëllim që aktet rregullatore të reflektojnë një ekuilibrim të interesave të konsumatorëve, investitorëve dhe shtetit. Do të merren masa për përmbushjen në vijim të detyrimit për të qenë transparentë, për të arsyetuar vendimarrjet, dhe për të sinjalizuar synimet tona paraprakisht. Eksperienca në shërbimet e furnizimit në këndveshtrimin e konsumatorëve por edhe të ofruesve të shërbimit konsiderohet një aset me mjaft rëndësi, që reflekton një shmangie të barrierave apo krijim të lehtësirave në treg.

ERE do të vijojë ti japë rëndësi krijimit dhe ruajtjes së lidhjeve të ngushta me konsumatorët e energjisë të të gjitha llojeve: familjet, bizneset, dhe përdoruesit e mëdhenj.

## **9.2- Plani i Veprimit**

Periudha e adresuar në këtë strategji është afatshkurtër, por ajo gjithsesi kërkon kryerjen e ndryshimeve të rëndësishme jo vetëm në atë që bëjmë, por edhe në mënyrën se si e bëjmë atë.

Fillimi i kësaj periudhe do të shohë gjithashtu implementimin e struktursë së re organizative të rregullatorit për të zbatuar masat e përshkruara më sipër. Sidoqoftë, ato imponojnë sfida të reja, të cilat mund të përmbushen vetëm nga një ndryshim i madh në mënyrën se si të gjithë punojmë: shkathhtësi dhe shpejtësi më e madhe, më shumë punë midis grupeve të punës për ta bërë ERE një autoritet më efektiv, më të aftë për të bërë një ndryshim pozitiv për konsumatorët dhe mbi të gjitha që ecën e përshtatet me hapat e shpejtë të zhvillimit teknologjik e ekonomik të sektorit energjistik. Vetë Bordi është i vendosur të ndryshojë natyrën e kontributit të tij, aty ku është e mundur drejt një fokusi më selektiv dhe strategjik mbi ndikimin e përgjithshëm të ERE në ofrimin e shërbimeve që rezultojnë në benefite për klientët fundorë të energjisë, qofshin ekzistues apo dhe të ardhshëm. Synimi ynë është të botojmë udhëzime më të hollësishme se si kjo strategji dhe përparësitë tona për këtë periudhë do të drejtojnë punën e ERE dhe planin tonë të punës.

Gjatë periudhës së implementimit të kësaj strategjie, ERE do të përgatise udhëzime të tilla në drejtim të analizës së impaktit të kuadrit rregullator. Bordi do të rishikojë rregullisht progresin që ERE po bën në shpërndarjen e përparësive dhe në ndryshimin e mënyrës së punës.

Përmes raportit tonë vjetor të ndikimit të konsumatorit, ne do të matim dhe publikojmë rregullisht progresin tonë në mbrojtjen e konsumatorëve dhe shpërndarjen e përparësive të përcaktuara në këtë dokument.

## **Kapitulli X**

### **Perfundime**

ERE do të kryejë analiza/studime të aspekteve të rëndësishme të kuadrit rregullator që kanë të bëjnë me çështjen e shërbimeve të rregulluara.

ERE do të shqyrtojë se si kuadri rregullator duhet të evoluojë në mënyrë dinamike për të mbajtur ritmin me ndryshimet e nxitura nga Covid-19 dhe të gjitha ndryshimet e tjera që ndikojnë në sistemin e energjisë.

ERE do të monitorojë zhvillimet në CyberSecurity gjithashtu.

ERE do të mbajë në fokus të punës dhe vëmendjes Konsumatorët dhe tregjet me pakicë.

Një pjesë e madhe e programit tonë të punës 2021-2023 është i dedikuar për mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorit, dhe për tregjet e pakices dhe nxitjen e konkurrencës së tregut të pakicës.

ERE do të promovojë, dhe bëjë përpjekjet më të mira për të përfshirë palët e interesit në vendimmarrje, për të perçuar besimin tonë në vlera të tilla si integriteti, thjeshtësia, gjithëpërfshirja, dhe mbi të gjitha Besimi dhe respekti i ndërsjellë.

Këto vlera përbëjnë Kulturën tonë të punës, një kulturë ku të gjithë kanë përgjegjësi për të vepruar për interesin afatgjatë të shoqërisë.